



FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS KOSOVO TABLE TENNIS ASSOCIATION

Shtëpia e Sportit, rr. Agim Ramadani nr. 253, kati I, zyra nr. 7, Prishtinë
Tel: +383-44-170-586 / Email: info@fppk.com / ueb: www.fppk.com

Procesverbal

Nga mbledhja e punës së Kuvendit të FPPK-së e mbajtur me 22.02.2026, në Hotel International në Prishtinë me fillim nga ora 11:00 .

Në mbledhje ishin prezent përfaqësues vijues të klubeve ::

1. Alban Hoxha:Kpp Ahmet Hoxha
2. Ridvan Hashani: Kpp Ahmet Hoxha F
3. Ardian Lamaxhema:Kpp Ahmet Hoxha MK
4. Jeton Azizi:Kpp Artana
5. Bledar Gerguri:Kpp Dardania
6. Gani Pireva: Kpp Drita M
7. Tahir Hamzaj : Kpp Fitorja Klinë
8. Ylli Maloku:Kpp Gani Maloku
9. Adhurim Bllaca:Kpp Gjilani F
10. Agron Brestrovci:Kpp Gjilani M
11. Argjent Ferati: Kpp Hasan Prishtina
12. Arton Haxhijaj: Kpp Istogu
13. Burim Kuçi:Kpp Juniku
14. Remzi Shala:Kpp Kvpp Prizreni
15. Besim Hajdari: Kpp Liria
16. Ekrem Mazreku: Kpp Llapusha
17. Qamil Vishaj: Kpp Maestro
18. Avni Kukaqi: Kpp Peja F
19. Milot Makolli: Kpp Priping
20. Nehat Çitaku:Kpp Shkolla
21. Erroll Karabaxhak.Kpp Shkolla Prizreni
22. Kreshnik Dacaj:Kpp Shqiponjat e zeza
23. Bekim Fazlija: Kpp Skenderaj
24. Fitim Krasniqi:Kpp TTC Ferizaj
25. Bahri Limolli:Kpp Ulpiana
26. Hekuran Podrimçaku: Kpp Vitomirica
27. Petrit Drenica:Kpp Vushtrria
28. Leoresa Imeri Kpp Vushtrria F

Me vonesë:

1. Veton Gota:Kpp Bashkimi
2. Rifat Rifati.Kpp Lidhja e Prizrenit

3. Nita Baymak: Kpp Ponte Prizren
4. Berkan Bajmak: Kpp Kalaja Pz(pa të drejtë vote)

Munguan përfaqësuesit e klubeve

1. .Kpp Dukagjini
2. Kpp Drita F
3. Kpp Prishtina
4. Kpp Prishtina F
5. Kpp Shpresa

Pjesëmarrës të tjerë: Jeton Oruçi – Kryetar i Federatës, Fadil Luta – Sekretar i Përgjithshëm, Blerina Boshnjaku – anëtare e bordit, Albana Krasniqi – zyrtare për administratë dhe financa, Rrita Mulaj – zyrtare për media dhe marketing, Leart Sveqla -Ekspert për Hartimin e Politikave dhe Projekteve Zhvillimore,dhe Samire Jupolli – fotografe.

Kuvendi u monitorua nga përfaqësuesi i KOK-ut, z. Musa Selimi.

Rendi i ditës

i miratuar nga Bordi Ekzekutiv i FPPK-së

1. Caktimi i personit për mbajtjen e Procesverbalit të Kuvendit dhe verifikimit të prezencës së delegatëve;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës së Kuvendit;
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së rregullt të Kuvendit nga viti 2025;
4. Raporti i regjistrimit për vitin kalendarik 2026;
5. Raporti i Punës së FPPK-së për vitin 2025;
6. Raporti Financiar i FPPK-së për vitin 2025;
7. Raporti i Auditorit për vitin 2024
8. Propozimi i buxhetit të FPPK-së për vitin 2026;
9. Propozimi i Kalendarit të FPPK-së për vitin 2026;
10. Propozimi i shortit të garave ekipore për vitin 2026
11. Plani Strategjik 2025-2030
12. Propozimet për ndryshime në aktet Normative
 - a. Ndryshimet në Statut
 - b. Rregullorja e Regjistrimit
 - c. Rregullorja e Sistemit të Garave
13. Temat e propozuara nga klubet për diskutim në Kuvend:
 - 12.1. KPP Ahmet Hoxha – propozimet
14. Të ndryshme;

Pika 1.

Caktimi i personit për mbajtjen e Procesverbalit të Kuvendit dhe verifikimit të prezencës së delegatëve;

Kryetari propozoi që procesverbalin ta mbajë Zyrtarja për Administratë dhe Financa: Albanë Krasniqi, që u aprovua njëzëri.

Kryetari i FPPK-së pasi i përshëndeti të pranishmit dhe i uroj mirëseardhje të gjithë të pranishmëve, kërkoi nga sekretari i përgjithshëm që të bëhet verifikimi i prezencës së Delegatëve dhe pas konstatimit të ekzistimit të kuorumit në kuvend, pasi ishin të pranishëm 31 pjesëmarrës me të drejtë vote, nga 37 përfaqësues të klubeve të FPPK-së,

Pika 2.

Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës së Kuvendit

Kryetari: Si fillim do ti lexoj të gjitha pikat e rendit të ditës dhe pasi i lexoi të gjitha pikat, tha se përfaqësuesi i KPP Shkolla, tek pika 14 “Të ndryshme”, ka propozuar që të përfshihen në rendin e ditës edhe këto pika:

1. Procesverbali i mbledhjes së fundit të Bordit Ekzekutiv, që të njëjtat janë përfshirë në rendin e ditës dhe janë shpërndarë.
2. Historiku i llogarisë bankare për vitin 2025, kjo pikë është e mbuluar me pjesën që është tek pika për Raportin Financiar dhe Raportin e Punës për vitin 2025.
3. Raporte të detajuara të hyrave dhe shpenzimeve për projektet e WTT, të njëjtat janë të paraqitura në Raportin e Punës dhe Raportin Financiar.
4. Raporti final i komisionit për regjistrim, përfshirë edhe listën finale të klubeve me të drejtë vote.
5. Raporti i punës të drejtorit të përfaqësueses, pikë e cila është pranuar; raportin e keni pranuar të gjithë ju,
6. Nominimi dhe zgjedhja e dy anëtarëve të bordit.

Nga këto 6 pika, si Bord Ekzekutiv kemi konsideruar se janë pranuar pjesërisht, në masë të madhe. Pra, procesverbalet janë ndarë, ndërsa pjesa e të hyrave dhe shpenzimeve për WTT është adresuar tek pjesa e Raportit të Punës dhe Raportit Financiar, ku do të kemi mundësi t'i diskutojmë kur të vijmë tek ato pika.

Të gjitha pikat janë përfshirë në rendin e ditës, përveç pikës së 2 të propozuar për historikun e llogarisë bankare, e cila nuk është përfshirë. Arsyeja e vetme është se Raporti Financiar do të realizohet në muajin mars, pasi duhet të presim deri sa të përfundojë auditimi. Ndërsa tek pika për nominimin dhe zgjedhjen e dy anëtarëve të bordit, unë si kryetar e kam vlerësuar se është e panevojshme të përfshihet në rendin e ditës.

Nehat Çitaku: Tek pika e parë, procesverbalet nuk janë dërguar me kohë. Pika 2 është kërkuar për të bërë transparencën. Pika 3, kjo është një praktikë e informimit real, ndërsa anëtarët në Kuvend i kanë si informatë vetëm 3 shifra. Pika 4, raportin final të komisionit e kam kërkuar sepse ka pasur edhe një afat shtesë për dokumente dhe është kërkuar për të ditur se sa anëtarë kanë të drejtë vote. Raporti i punës së drejtorit është dërguar më vonë, kështu që duhet të shqyrtohet dhe të futet edhe kjo pikë në rend të ditës. Pika e fundit, nëse kryetari pak më parë tha se është e drejtë e imja, po është e drejtë e jotja të propozosh, mirëpo është Kuvendi ai që vendos nëse do ta marrin vendin të propozuarit e tu.

Kryetari: Historikun e llogarisë bankare, me të drejtë thatë, mundemi qysh nesër te ua përcjellim për hir të korrektësisë dhe, pasi të bëhet auditimi, jua përcjellim të gjitha së bashku. Ndërsa tek pika “Të ndryshme”, mund ta fusim raportin e drejtorit të përfaqësueses, pasi ne jua kemi dërguar raportin, por për shkak të punëve të shumta që kemi pasur, kemi harruar ta fusim në rendin e ditës këtë pikë.

Besim Hajdari: Tek pika e fundit “Të ndryshme” të përfshihet edhe diskutimi për vlerësimin e më të mirëve për vitin 2025, si proces se si ka kaluar, për shkak se ne kemi shprehur pakënaqësi, por duam që edhe në këtë Kuvend ta diskutojmë këtë çështje

Kryetari: Nëse jeni të pajtimit, e kishim futur këtë pikë në një Kuvend tjetër për shkak se kemi mjaft pika për të diskutuar sot.

Besim Hajdari: Nuk është mirë, Kryetar, që të shtyhen diskutimet për një Kuvend tjetër, por mundemi me i hedh në votim nëse janë të pajtimit edhe kuvendarët.

Kryetari: Atëherë i kemi dy propozime nga KPP Shkolla që të përfshihet raporti i drejtorit të përfaqësueses, dhe nga KPP Liria që të përfshihet në rendin e ditës vlerësimi i laureatëve.

Ridvan Hashani: Është mirë që edhe pika për anëtar të bordit të përfshihet në rend të ditës, për hir të korrektësisë. Mundemi edhe këtë pikë me e vendos në rend të ditës dhe me e hedh në votim.

Kryetari: Kur të kalojmë, Ridvan, në mbledhjet e radhës do të jetë edhe kjo pikë e përfshirë. Ndërsa për sot kemi shumë pika të tjera për të diskutuar. Për sot, nëse jeni të pajtimit, e hedhim në votim që, përveç atyre pikave të rendit të ditës, në “Të ndryshme” të futen edhe dy propozimet: raporti i drejtorit të përfaqësueses dhe pika tjetër për laureatët.

Hidhet në votim për rendin e ditës: 13 për, 13 kundër.

Kryetari e lexoi nenin 15, paragrafi 15 të Statutit të Federatës së Pingpongut, i cili thotë se nëse ka vota të barabarta për çdo çështje, vota e udhëheqësit të Kuvendit është votë përcaktuese.

Meqenëse votat ishin të njëjta, fjalën e mori Musa Selimi, i cili ishte monitorues nga KOKU.

Musa Selimi: Si fillim, përshëndetje për të gjithë. Në emër të Kryetarit të Komitetit Olimpik të Kosovës, z. Ismet Krasniqi, jam i deleguar që të jem prezent sot këtu për të monitoruar këtë Kuvend. Fillimisht, ju përgëzoj për punën dhe aktivitetet që keni zhvilluar gjatë vitit të kaluar. Me të vërtetë, është një punë që mund të merret shembull edhe nga federatat e tjera. Sa i përket

çështjeve statutore që janë propozuar, nuk kam informacion të detajuar për t'i komentuar. Megjithatë, dua të theksoj se ju të gjithë jeni kolegë dhe do të vazhdoni të takoheni rregullisht në gara dhe aktivitete të ndryshme.

Ju bëj thirrje që çdo mosmarrëveshje apo çështje me natyrë personale të lihet anash, në funksion të sportit, të zhvillimit të pingpongut dhe në interes të sportistëve.

Nga delegatët u kërkua që edhe një herë të bëhet numërimi i delegatëve se sa janë të pranishëm në Kuvend.

Sekretari fillon me numërimin e delegatëve dhe konstatoi se të pranishëm janë 31 delegatë me të drejtë vote.

Më pas kalohet në votim edhe një herë për rendin e ditës të propozuar ku:15 për, 14 kundër.

Dhe, meqenëse kishte ende diskutime se nuk po bëhej numërimi i saktë i votave, nga Kryetari u kërkua që të formohet një komision verifikues prej tre personash për të gjitha pikat e rendit të ditës.

Si anëtarë të komisionit u zgjodhën: Veton Gota, Qamil Vishaj dhe Fadil Luta.

Më pas, votimi për rendin e ditës u përsërit ku ishin: 15 për,15 kundër.

Kryetari: Atëherë, me këtë unë e konsideroj të kaluar rendin e ditës, sepse siç e lexova edhe më lartë Statutin, nëse votat janë të njëjta, vota e udhëheqësit të Kuvendit është votë përcaktuese.

U shprehën shqetësime nga delegatë të ndryshëm se numërimi i votave nuk është bërë saktë nga anëtarët e komisionit, sepse një person nuk ka votuar, ndërkohë që në Kuvend ishin të pranishëm 31 delegatë.

Kryetari: Ju kisha lutur të vazhdojmë me rendin e ditës, sepse numërimi është bërë dhe rendi i ditës ka kaluar, le të vazhdojmë me punën.Meqenëse të dy pikat e para u votuan dhe kaluan, vazhdojmë tek pika e tretë e rendit të ditës.

Pika 3.

Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së rregullt të Kuvendit nga viti 2025

Kryetari: Procesverbalin e keni pranuar, vërejtje nuk ka pasur, e hedhim në votim

Nehat Çitaku: Procesverballi nuk është në rregull, sepse unë kam qenë ai person që e kam udhëhequr mbledhjen deri në momentin kur është formuar komisioni për zgjedhje. Kështuqë unë duhet ta nënshkruaj deri në atë pjesë, pra unë duhet të nënshkruaj deri kur kam qenë duke e udhëhequr, pastaj e nënshkruan ti prej nga je zgjedhur.

Kryetari: A jeni të pajtimit që ta bëjmë këtë ndryshim? Proceduralisht e kryejmë nënshkrimin pas votimit, por a jeni të pajtimit që deri në pjesën ku e ka udhëhequr ish-kryetari ta nënshkruaj ai, e pastaj për pikat e tjera unë, pas zgjedhjes sime si kryetar.

Nehati Çitaku: Më vjen keq, i nderuar zyrtar i KOK-ut, por ne duhet ta lirojmë sallën, sepse nuk mund të jemi pjesë e një shkeljeje drastike të Statutit.

Dhe më pas, së bashku me Nehat Çitakun, u larguan nga salla disa prej delegatëve.

Kryetari: Më vjen keq që një pjesë e delegatëve e lëshuan sallën. Unë shpresoj që do të kthehen për të mirën e sportistëve, me të cilët ju punoni çdo ditë. Është vërtet për keqardhje që problemet e natyrës personale apo politike të reflektohen në dëm të sportit të pingpongut të Kosovës.






Kisha kërkuar nga sekretari që të verifikojë nëse kemi kuorum për të vazhduar me kuvend.

U verifikua se nuk ka kuorum pasi në sallë ishin vetëm 16 delegatë me të drejtë vote, për të vazhduar me pikat e tjera të rendit të ditës. Kryetari shprehu keqardhje për situatën e krijuar dhe theksoi se shumë shpejt do të ju informojmë për datën e radhës se kur do të mbahet Kuvendi përsëri.

Kuvendi përfundoi në orën 13:30.

Kuvendi i rregullt 22 02 2026 Lista e delegatëve

Klubet me të drejtë vote

N r	EMRI I KLUBIT	KOMUNA	DELEGATI	nr personal	Nënshkrimi
1	Kpp Ahmet Hoxha	Ferizaj	1 Alban Hoxha 1	1030661784	
2	Kpp Ahmet Hoxha F	Ferizaj	2 Ridvan Hashani 2	1011623421	
3	Kpp Ahmet Hoxha MK	Ferizaj	3 Ardian Lamaxhema 3	1003437341	
4	Kpp Artana	Novobërda	4 Jeton Azizi 4	2005828107	
5	Kpp Bashkimi	Prizren	5 Veton Gota 29	1230398450	
6	Kpp Dardania	Prishtina	6 Bledar Gerguri 5	1174246102	
7	Kpp Drita F	Gjilan	Skender Zeqiri	1011892376	
8	Kpp Drita M	Gjilan	31 Gani Pireva 6	1012887104	
9	Kpp Dukagjini	Klinë			
10	Kpp Fitorja Klinë	Klinë	7 Tahir Hamzaj 7	1002508296	
11	Kpp Gani Maloku	Ferizaj	8 Ylli Maloku 8	1004479960	
12	Kpp Gjilani F	Gjilan	9 Adhurim Bllaca 9	1002991132	
13	Kpp Gjilani M	Gjilan	10 Arson Brostori 10 1012355995 2602458127		
14	Kpp Hasan Prishtina	Vushtrri	11 Argjend Ferati 12	1231146403	
15	Kpp Istogu	Istog	12 Arton Haxhijaj 11	1231146403	
16	Kpp Juniku	Junik	13 Burim Kuçi 13	1173532730	
17	Kpp Kosovari	Fushëkosovë	Jahja Tërmkolli	1013538073	
18	Kpp KVPP Prizreni	Prizren	14 Remzi Shala 14	1002693930	
19	Kpp Lidhja e Prizrenit	Prizren	15 Rifat Rifati 20	1173096077	
20	Kpp Liria	Prizren	16 Besim Hajdari 15	1016489456	
21	Kpp Llapusha	Malishevë	17 Ekrem Mazreku 16	1002805126	
22	Kpp Maestro	Peja	18 Qamil Vishaj 17	1009287082	
23	Kpp Peja F 2020	Peja	19 Avni Kukaqi 18	1030131815	
24	Kpp Ponte Prizren	Prizren	20 Nita Baymak 31	1173417515	
25	Kpp Priping	Prishtina	21 Nilot Malicli 19	1500993542	
26	Kpp Prishtina	Prishtina			
27	Kpp Prishtina F	Prishtina			